

2025 - Fewer Health Procurement Procedures, Greater Competition, and Better Savings of Public Funds

Together for Life (TFL) has published the monitoring report "Public Procurement and the Efficiency of Public Expenditure in the Health Sector – 2025," which analyses the public procurement procedures carried out by the Ministry of Health and Social Welfare (MoHSW) in the health sector.

The report identifies a significant improvement in the level of competition compared with the procurement procedures conducted by the Ministry during 2024. While the 2024 monitoring revealed a very low level of competition, with an average of only 1.37 economic operators participating in each procurement procedure and a considerable number of tenders receiving only a single bid, the procurement procedure monitored in 2025 attracted between seven and

the first stage of the procedure, demonstrates genuine and effective competition rather than merely formal competition.

The higher level of competition also resulted in substantially greater economic efficiency. The winning bids were significantly lower than the estimated contract value (ceiling budget), with differences ranging from 43% to 75%, generating considerable savings for the state budget.

Another positive development concerns the distribution of contracts. In the procurement procedure monitored in 2025, contracts were awarded to four different economic operators, reflecting broader market participation. This represents a significant improvement compared with the findings of the 2024 monitoring, which showed that 72% of the contracts awarded by the Ministry of Health and Social Welfare were concentrated among only ten companies.



The report also provides a detailed assessment of the procurement procedure, beginning with the preparation of the Standard Tender Documents. According to the findings, the tender documentation was prepared in compliance with the applicable legislation and did not create artificial barriers that could restrict the participation of economic operators.

the methodology used to calculate the ceiling budget. These gaps suggest that the initial cost estimates were not sufficiently based on market analysis and prevailing market prices, which would allow for more realistic budget planning and an even more efficient use of public funds. For this reason, the report recommends strengthening market analysis during the procurement planning phase, increasing the transparency of procurement documentation, and institutionalising post-procurement evaluations to further improve efficiency and the management of public funds.

Click here to read the full report



2025 - Më pak tendera në shëndetësi, më shumë konkurrencë dhe kursim të parave publike

"Prokurimet dhe Efikasiteti i Shpenzimeve Publike në Fushën e Shëndetësisë për Vitin 2025", i cili analizon procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) në sektorin e shëndetësisë.

Raporti evidenton një përmirësim të ndjeshëm të nivelit të konkurrencës krahasuar me tenderët e zhvilluar nga MSHMS gjatë vitit 2024. Ndërsa monitorimi i vitit 2024 evidentonte një nivel shumë të ulët konkurrence, me një mesatare prej vetëm 1.37 operatorësh ekonomikë për procedurë dhe një numër të konsiderueshëm tenderësh me vetëm një ofertues, procedura e monitoruar gjatë vitit 2025 tërhoqi nga shtatë deri në trembëdhjetë oferta për secilin lot. Sipas raportit, mungesa e rasteve me një ofertues të vetëm, së bashku me numrin e lartë të operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës, përbëjnë tregues të një konkurrence reale dhe efektive.

Rritja e konkurrencës është shoqëruar edhe me një përmirësim të ndjeshëm të efikasitetit ekonomik. Ofertat fituese rezultuan dukshëm më të ulëta se fondi limit, me diferenca që variojnë nga 43% deri në 75%, duke gjeneruar kursime të konsiderueshme për buxhetin e shtetit.

Një tjetër zhvillim pozitiv lidhet me shpërndarjen e kontratave. Në procedurën e monitoruar gjatë vitit 2025, kontratat u shpërndanë ndërmjet katër operatorëve ekonomikë të ndryshëm, duke reflektuar një konkurrencë më të gjerë në treg. Kjo paraqet një ndryshim të dukshëm krahasuar me monitorimin e vitit 2024, i cili evidentoi se 72% e kontratave të lidhura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ishin përqendruar tek vetëm dhjetë kompani.

Raporti ofron gjithashtu një analizë të detajuar të procedurës së prokurimit, duke filluar nga hartimi i Dokumenteve Standarde të Tenderit. Sipas gjetjeve, dokumentacioni rezulton i përgatitur në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk ka krijuar barriera artificiale që do të kufizonin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.



Megjithatë, raporti evidenton se diferencat e konsiderueshme ndërmjet fondit limit dhe ofertave fituese mund të jenë tregues i mangësive në metodologjinë e përllogaritjes së fondit limit. Këto diferenca sugjerojnë se vlerësimet paraprake të kostove nuk janë bazuar mjaftueshëm në analizën e tregut dhe në çmimet reale, çka do të mundësonte një planifikim buxhetor më realist dhe një përdorim edhe më efikas të fondeve publike. Për këtë arsye, raporti rekomandon forcimin e analizës së tregut gjatë fazës së planifikimit të prokurimeve, rritjen e transparencës së dokumentacionit të procedurave dhe institucionalizimin e analizave pas përfundimit të prokurimeve, me synim përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit dhe të menaxhimit të fondeve publike.

Përveç analizës së prokurimeve, raporti vlerëson edhe efikasitetin e shpenzimeve publike në sektorin e shëndetësisë. Gjetjet tregojnë se, megjithëse buxheti për shëndetësinë ka vijuar të rritet në terma nominalë, pesha e tij ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe ndaj shpenzimeve totale publike mbetet e ulët. Raporti evidenton gjithashtu rënien e financimit për kujdesin shëndetësor parësor dhe faktin se Shqipëria vijon të ketë një nga nivelet më të larta të pagesave nga xhepi për shërbimet shëndetësore në rajon.

Kliko këtu për të lexuar raportin e plotë

Copyright © 2026 Together for Life, All rights reserved.
You are receiving this email as a valued partner of *Together for Life organization*

TOGETHER FOR LIFE
Office Address: Rr. Brigada VIII, Pallati Jeshil Tekno- Projekt, Shk.2, Ap.13, Tiranë
Phone Number: 0692066522
E-mail address: info@togetherforlife.org.al
Web: togetherforlife.org.al